# DËSHMI ARKIVI

**A-441265**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama: Jemi ngritur në nivel të lartë të mbrojtjes kibernetike. Po punojmë për e-Albania 2.0, standarde të reja shërbimi dhe aksesueshmëri më të lehtë |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/08/rama-jemi-ngritur-ne-nivel-te-larte-te-mbrojtjes-kibernetike-po-punojme-per-e-albania-2-0-standarde-te-reja-sherbimi-dhe-aksesueshmeri-me-te-lehte/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:36:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 13:11:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9baec5b01a799cb4ab58cc744cc5c418deb85cc8fe4d08d2d7693ddae4ecfe43` |
| TEKSTI | `c90bd04b2232cd57fb3dc1bab6f9eec35507a4363d992ac5bedfbb9bd8b94f0e` |
| PAMJA | `ee41758cdc281639c273a8e907a8c37a848c2ae696bb749afdd0d2f25a62e876` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dfbf339860e2617fdf6c10b75a40191c187858e1268414c5873617bf4d955b5f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dfbf339860e2617fdf6c10b75a40191c187858e1268414c5873617bf4d955b5f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama: Jemi ngritur në nivel të lartë të mbrojtjes kibernetike. Po punojmë për e-Albania 2.0, standarde të reja shërbimi dhe aksesueshmëri më të lehtë

Politikë

Publikuar: 08/09/2026




Kryeministri Edi Rama mori pjesë në Forumin e Dytë të Inovacionit, me fokus Inteligjencën Artificiale dhe zhvillimin e sektorit të teknologjisë në Shqipëri, ku foli për transformimin digjital të vendit dhe sfidat që sjell ritmi i shpejtë i zhvillimit teknologjik.

Rama tha se zhvillimet e reja në teknologji përbëjnë një mundësi të madhe për Shqipërinë, por njëkohësisht edhe një sinjal alarmi, pasi vendi rrezikon të mbetet pas nëse nuk ecën me ritmin e kohës.

"*Jemi të vetëdijshëm që të gjitha temat e diskutimit janë një dinamikë të jashtëzakonshme, gjë që është një bekimi madh për vende si ynë, sepse mund të bëjmë kapërcime të mëdha falë teknologjisë dhe nga ana tjetër është sinjal i vazhdueshëm alarmi sepse mund të ngelim shumë mbrapa nëse nuk ecim me ritmin e kësaj kohe të re*", tha ai.

Duke folur për zhvillimin e teknologjisë në Shqipëri, Rama tha se sektori sot eksporton 222 milionë euro produkte, rreth tre herë më shumë se disa vite më parë, ndërsa numri i profesionistëve të teknologjisë ka arritur në afro 30 mijë.

Sipas tij, shtatë në dhjetë profesionistë të këtij sektori janë nën moshën 35 vjeç, ndërsa teknologjia ka një peshë prej 2.2% në prodhimin e përgjithshëm kombëtar.

"*Disa të dhëna tregojnë se në çfarë dinamike të*

## Më të lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I "Tmerrshmi i Beratit" / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, saga e ...


Porelli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

*jashtëzakonshme është sektori i teknologjisë që sot eksporton 222 mln euro produkte, tre  herë më shumë se sa pak vite  më parë. Sot  në këtë sektor janë aktivë thuajse 30 mijë profesionistë të  teknologjisë, shifër që ka ndryshuar  edhe brenda këtij viti dhe 7 nga 10 protagonistë të këtij sektori janë nën moshën 35 vjeç. Kemi një rritje pagash shumë domethënëse në këtë sektor dhe në prodhimin e përgjithshëm kombëtar, sektori ka një peshë të lexueshme prej 2.2%. duhet të jetë më e lartë, por është një shofer kuptimplotë për potencialin e vet*", theksoi ai.

Një pjesë të rëndësishme të fjalës së tij Rama ia kushtoi sigurisë kibernetike, duke deklaruar se Shqipëria është ngritur në një nivel të lartë të mbrojtjes kibernetike. Ai iu referua renditjes së National Cyber Security Index 2026, ku, sipas tij, Shqipëria renditet në vendin e parë.

"*Ngritja e Shqipërisë në nivelin më të lartë të mbrojtjes kibernetike, gjë e nënvizuar edhe nga National Cyber Security Index 2026, ku Shqipëria rankohet në vendin e parë. Nuk ka asnjë çudi në këtë mes sepse ky është bekimi i teknologjisë, të jep mundësi të bësh kapërcime që përndryshe do ishin jashtëzakonisht më të ngadalta. Na u desh një sulm i egër mbi infrastrukturën tonë digjitale për të marrë masa, për të investuar në mbrojtjen kibernetike dhe për të patur sot një modul shumë të zhvilluar të mbrojtjes kibernetike*", deklaroi kreu i qeverisë.

Sipas Ramës, e-Albania 2.0 do të sjellë standarde të reja shërbimi dhe aksesueshmëri më të lehtë për qytetarët, duke e çuar më tej procesin e digjitalizimit të administratës publike.

Ai u ndal edhe te "Diella", duke thënë se sistemi tashmë është konsoliduar dhe se qeveria po punon për shtrirjen e teknologjisë së Inteligjencës Artificiale edhe në fusha të tjera të administrimit publik.

"*Aktualisht jemi në rritje të vazhdueshëm të aplikimeve në platformën ealbania. Në ndërkohë që jemi duke punuar për të ndërtuar të parin sistem 360 gradë të prokurorimit publik me inteligjencë artificiale dhe për të ridizjanuar ealbanian dhe për të hyrë në gjeneratën e dytë të saj, ealbania 2.0, me standarde të reja shërbimi dhe aksesueshmëri shumë më të lehtë. Të gjitha këto janë pjesë e një procesi që vazhdon. Diella tani është konsoliduar dhe po punojmë për të shtrirë modulin me fëmijët e Diellës edhe në zona të tjerat ë administrimit publik"*, bëri me dije Rama.

TAG: Edi rama

## Të ngjashme







**“Ne kemi qesen tonë”, Rama publikon fjalët e gjykatësit: Ja kështu e shohin këta buxhetin e shqiptarëve**



**Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozita numëron kushërinjtë**



**Reforma territoriale, Rama nga Berati: Poliçani dhe Dimali do të marrin të njëjtat shërbime, por brenda bashkisë Berat**

## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

**KREU** **INVESTIGIM**
**KRIM & KORRUPSION** **DOSJE ROZË**
**KRYESORE** **POLITIKË** **EKONOMI**
**ANALIZË** **RAJON** **KULTURË** **SPORT**

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.